



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.182/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike, përkatësisht në shtylla elektriket, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.182/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit të kandidatës në shtyllë elektrike me, për fushatën zgjedhore në rrugë publike –në Komunën e Prizrenit, i shqiptohet gjobë në vlerë prej 5,100.00 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Urdhërohet subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që brenda afatit prej 24 orëve, nga pranimi i këtij vendimi, ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 02.10.2019, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datën 02.10.2019, zyra ligjore e PDK-së, rreth orës 11:22 ka vërejtur se kandidatja për deputete e subjektit politik LDK, ka vendosur posterin në telat e shtyllës elektrike në vend publik, në Fshatin Dedaj, Komuna e Prizrenit.

Me këtë rast paraqitsi i ankesës pretendon subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Në përgjigjën në ankesë, subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), të datës 03.10.2019, konsiderojnë se ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është e pabazë, sepse në kushte dhe rrethana me të cilën është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, dhe komunat nuk kanë arritur ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë

hapësira të veçanta. Më tutje subjekti politik LDK thekson se shtyllat elektrike, pavarësisht faktit që është “pronë publike” në Kosovë zakonisht janë përdorur, në mungesë të hapsirave të dedikuara për këtë, për vendosjen e njoftimeve të ndryshme mbi ngjarjen dhe zhvillimin në komunën përkatse, dhe sipas tyre nuk cenon funksionalitetin e saj për faktin që vendoset në poster apo një njoftim i kandidatës aty.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në përgjigjen e tij, njofton se , pavarësisht kësaj ka ndërmarr masat e duhura duke evituar “shkeljen” e pretenduar nga kandidati në fjalë, duke larguar foto- posterin në shtyllën elektrike, për këtë kandidatja ka bashkangjitur provën.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatës për deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), dega në Prizren, është vendosur në shtyllë elektrike në Prizren, në hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana Lidhjes Demokratike Demokratike të Kosovës(LDK), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatës për deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), janë vendosur në shtylla elektrike hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), në përgjigjen në ankesë i datës 03.10.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatës për deputete të këtij subjekti politik është vendosur në hapsirë publike.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmiruese, ku është evituar shkelja, duke dorëzuar një

fotografi si provë. Paneli me rastin e vlerësimit të përmirësimit të shkeljes nga ana e subjektit ka konstatuar se nuk bëhet fjalë për vendin e njëjtë, kjo vërehet sidomos kur krahasohen dy fotografitë, andaj paneli nuk e mori për bazë fotografinë e dorëzuar nga LDK dhe në këtë rast subjekti në fjalë, konsiderohet se nuk ka ndërmarr masa drejtë përmirësimit të shkeljes së evidentuar. Meqenëse nuk janë ndërmarr masat drejtë përmirësimit të shkeljes, kjo dhe rrethanat e cekura më lartë kanë qenë përcaktuese me rastin e shqiptimit të lartësisë së gjobës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 182/2019 më datën 04.10.2019.

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi*